VENDIM
Nr. 459, datë 26.7.2018

PËR KALIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË ROSKOVEC, TË PRONËS ME EMËRTIMIN "POSTA E POLICISË ROSKOVEC" DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 250, DATË 24.4.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË RENDIT PUBLIK", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, shkronjës "k", të nenit 3, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, dhe të neneve 5, 13 e 15, shkronja "c", të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi të Bashkisë Roskovec të pronës me emërtimin "Posta e Policisë Roskovec", sipas formularit që i bashkëlidhet këtij vendimi, për realizimin e funksioneve me interes vendor.

2. Prona e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore që i bashkëlidhet vendimit nr. 250, datë 24.4.2003, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.

3. Ngarkohen ministri i Brendshëm, kryetari i Bashkisë Roskovec dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

1. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË VEÇANTA)

INSTITUCIONI I PUSHTETIT QENDROR MRP (DREJTORIA E POLICISË SË QARKUT FIER)
BASHKIA/KOMUNA ROSKOVEC
FUSHA E PËRDORIMIT TË PRONËS: RUAJTJE RENDI

Nr. rend.	Zona kadas. indeksi i hartës	Nr. i pasurisë	Lloji i pronës	Emri i pronës, adresa	Sip. totale e pronës (m^2)	Nga sip. totale, sa ndërtesë m^2	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni/enti me përgjegjësi administrative	Institucioni/enti përdorues Statusi juridik përdorimit	Të dhëna të tjera (shënime të veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
										Ardhur me shkresën nr. 675/2, datë 22.7.2002
				Posta e Policisë Roskovec	576	138	Ruajtje rendi	MRP	Kom. i Policisë Fier	